

GFI Albania sh.p.k.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020

(shumat ne Lek)

1. Informacion i Përgjithshëm

Shoqëria GFI Albania sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria") është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit më datë 5 prill 2013 dhe pranë Degës së Tatimeve dhe Taksave Tiranë më NIPT L31605014G.

Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet në përputhje me dispozitat përkatëse të Ligjit 9901, datë 14 prill 2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", si dhe nga akti i themelimit dhe statuti i saj. Objekti kryesor i aktivitetit të Shoqërisë është ai i përcaktuar në Kontratën Koncesionare "Për shërbimin e Markimit dhe të Monitorimit të Karburantëve", të nënshkruar më datë 27 shkurt 2013 midis ortakëve të Shoqërisë dhe Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë (më poshtë referuar si "Kontrata Koncesionare"). Sipas kësaj të fundit, objekti kryesor i aktivitetit të Shoqërisë është ndërtimi dhe testimi i sistemit operativ për ofrimin e shërbimit të markimit dhe monitorimit të karburantëve në Republikën e Shqipërisë, shfrytëzimi i sistemit operativ, dhe transferimi i pajisjeve të sistemit operativ për monitorimin e karburantëve në Republikën e Shqipërisë tek Ministria e Financave pas përfundimit të afatit të Koncesionit. Kontrata e Koncesionit ka një afat dhjetëvjeçar nga data efektive e saj e cila përfundon më 27 shkurt 2023.

Shoqëria zotërohet nga ortakët Petroleum Consulting Partners A.G. dhe Global Fluids International S.A., të cilët më 31 dhjetor 2019 zotërojnë respektivisht 99.93% dhe 0.07% të kapitalit themeltar.

Administratorët e Shoqërisë janë Z. Vangjel Birbo dhe Z. Dorian Deltina. Secili prej administratorëve ka kompetencë për të përfaqësuar Shoqërinë i vetëm.

Selia kryesore e Shoqërisë ndodhet në Rrugen "Murat Toptani", Eurocol Business Center, kati i dytë, Tiranë dhe selia dytësore ndodhet në Autostraden Tiranë-Durrës, Km. 6, Kashar, Tiranë.

Numri i punonjësve të Shoqërisë më 31 dhjetor 2020 është 63 (2019:66).

Parimi i vijimësisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e vijimësisë. Kapitali i përgjithshëm i Shoqërisë është në vlera pozitive. Gjatë fillimit të vitit 2020, u përhap pandemia COVID-19, ku në Shqipëri impaktin masiv e pati në muajin mars 2020, kur u morën masa drastike për parandalimin e përhapjes duke mbyllur shumë prej aktiviteteve.

Drejtimi i Shoqërisë vlerëson që pandemia COVID-19 në uljen e shitjeve të Shoqërisë e cila operon në fushën e markimit të karburantëve dhe që do të impaktojë negativisht në periudhat e mëpasshme të ushtrimit të aktivitetit. Drejtimi i Shoqërisë nuk është në gjendje të bëjë një vlerësim paraprak të këtij impakti.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave

2.1 Pajtueshmëria

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) dhe ligjit Nr. 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" në fuqi në Shqipëri.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

GFI Albania sh.p.k.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020

(shumat ne Lek)

2.3 Periudhat krahasimore

Të dhënat e periudhave të mëparshme janë riklasifikuar për t'i bërë ato të krahasueshme me paraqitjen e të dhënave të periudhës ushtrimore.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lekë, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5 Vleresime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të kompanisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vleresimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshmë. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacionet mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare.

3. Politikat kontabel

Politikat kontabel të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente nga Shoqëria, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

3.1 Transaksionet ne monedhe te huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetare është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jomonetare në monedhe të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit, ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit të përdorura në konvertimin e aseteve dhe detyrimeve monetare në monedhë të huaj janë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Euro/Lek	123.70	121.77
Usd/Lek	100.84	108.64

GFI Albania sh.p.k.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020

(shumat ne Lek)

3.2 Instrumenta financiare

Instrumentat financiare joderivative përbehen nga llogari të arketueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna, dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiare joderivative njihen fillimisht më vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur më vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në shpenzime dhe të ardhura. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiar joderivative maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur Shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë (mjetet monetare) përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhese dhe depozitat në bankat. Për qellime të pasqyrës së fluksit të parase, paraja dhe ekuivalentët të saj përfshijnë depozita pa afat dhe depozita më një afat maturimi prej tre muajsh ose më pak që nga data fillestare.

Llogari të arketueshme

Llogaritë e arketueshme (kërkesat e arketueshme) njihen fillimisht më vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjoni për zhvlerësimin e aktiveve të arketueshme llogaritet kur ka të dhëna se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar, mospagesa ose pagesa të vonuara konsiderohen tregues që llogaritë e arketueshme të zhvlerësohen. Shuma e provigjionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten më vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht më vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksionëve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten më kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis vlerës fillestare dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar në metodën e interesit efektiv.

Të tjera

Instrumenta të tjere joderivative maten më kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

GFI Albania sh.p.k.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020

(shumat ne Lek)

3.3 Inventare

Inventarët përcaktohen me vlerën më të vogël midis kostos dhe çmimit të shitjes duke zbritur kostot e transaksionit. Kostoja përcaktohet duke përdorur metoden e mesatares së ponderuar dhe përfshin shpenzimet e kryera për përfitimin e inventarit dhe kosto të tjera të kryera për dërgimin e inventareve në destinacion më kushtet e kerkuara. Çmimi i shitjes i referohet vlerës neto që Shoqëria pret të përfitojë nga shitja e inventarit, në rrjedhjen normale të biznesit, minus kostot e shitjes.

3.4 Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Në rastet kur pjesë të një aktivit afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes më vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që Shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzime kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis afatit të koncesionit dhe jetës së vlerësuar të dobishme të aktivit duke filluar nga dita kur ai është i gatshëm për përdorim. Aktivet e marra më qira financiare amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirase dhe jetës së dobishme të aktivit. Toka nuk amortizohet.

Metodat e amortizimit dhe përqindjet përkatëse sipas grupeve të aktiveve afatgjata për periudhën aktuale janë si më poshtë:

Aktive të qëndrueshme	%
Ndertesa	10
Përmirësime në qiramarrje	10
Makineri dhe pajisje	20
Mjete transporti	20
Orendi dhe pajisje	20
Kompjutëra dhe pajisje informative	25

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

Brenda aktiveve afatgjata janë paraqitur edhe aktivet afatgjata të cilat kanë lidhje me koncesionin, të cilat nuk janë paraqitur më vetë për shkak të natyrës të këtyre aktiveve.

GFI Albania sh.p.k.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020

(shumat ne Lek)

3.5 Aktive afatgjata jomateriale

Aktivet afatgjata jomateriale qe kanë një jetë të përcaktuar matën më kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi. Amortizimi llogaritet mbi koston e blerjes së aktivit. Shuma e amortizimit kalon në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në mënyre lineare përgjatë jetës së aktivit.

3.6 Zhvlerësimi

Aktivet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parase, të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyre individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyre të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me një aktiv financiar të disponueshem për shitje i njohur më parë në kapital, transferohet në shpenzime.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Aktivet jofinanciare

Vlera e mbetur e aktiveve jofinanciare të Shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëhere vlerësohet vlera e rikuperueshmë e aktivit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.7 Provigjonet

Një provigjon njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyre të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalese parash për shlyerjen e tij. Provigjonët përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parase me një normë skontimi që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohe të parase dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

GFI Albania sh.p.k.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020

(shumat ne Lek)

3.8 Njohja e te ardhurave

Të ardhurat janë flukset hyrese bruto të përfitimeve ekonomike lindur në rrjedhën normale të aktiviteteve të Shoqërisë që rezultojnë në rritje të kapitalit neto gjatë periudhës dhe nuk përfshijnë rritjet e kapitalit neto në sajë të kontributëve të ortakeve. Të ardhurat përfshijnë vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar apo të arkëtueshme nga shitja e mallrave dhe shërbimeve në rrjedhën normale të aktiviteteve të Shoqërisë. Të ardhurat nuk përfshijnë tatimin e vlerës së shtuar, kthimet, rabatët dhe zbritjet, nëse ka.

Të ardhurat nga shërbimi i markimit

Shoqëria kryen shërbimin e markimit siç parashikohet në Kontratën e Konçesionit. Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e raportimit. Asnje e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse. Këto shërbime ofrohen me një çmim fiks dhe në mënyrë të vazhdueshme nga Shoqëria.

3.9 Te ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi për llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metoden e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarise fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.10 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin njihet si fitim ose humbje përveç nëse lidhet me zera të njohur direkt në kapital, rast në të cilin njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi që pritët të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që konsiderohet në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshem për vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë lind nga ndryshimet mes vlerave të njohura për aktivet dhe detyrimet e shoqërisë të paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar në përputhje me kërkesat e SKK dhe vlerave të njohura të këtyre aktiveve dhe detyrimeve nga autoritetet tatimore.

GFI Albania sh.p.k.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020

(shumat ne Lek)

4.1 Menaxhimi i riskut financiar

Aktiviteti i kompanise eshte i ekspozuar kundrejt disa risqeve financiare si: risku i kursit te kembimit, risku i kredise dhe risku i perqindjes se interesit. Menaxhimi i riskut financiar drejtohet dhe fokusohet ne paparashikueshemrine e tregut financiar dhe synon te minimizojë efektet potenciale te papelqyeshme. Menaxhimi i riskut financiar ndermerret nga departamenti financiar i kompanise mēme sipas politikave te aprovuara nga bordi.

(i) Risku nga kursi i kembimit

Shoqeria eshte e ekspozuar ndaj rrezikut te kursit te kembimit qe vjen si rezultat i ekspozimit ne monedha te ndryshme kryesisht ne lidhje me Euro-n dhe USD-n. Shoqeria nuk perdor ndonje instrument per tu mbrojtur ndaj rrezikut te kursit te kembimit. Drejtimi i shoqerise eshte pergjegjes per te mbajtur pozicione neto te pershtatshme ne cdo monedhe dhe ne total dhe te monitoroje operacionet e perditshme.

Ekspozimi i shoqerise ndaj kursit te kembimit me 31 dhjetor 2020 dhe 2019 ka qene si me poshte:

31 dhjetor 2020	Euro	USD	Leke	Totali
Mjete Monetare	266,768	672,940	113,425,749	114,365,477
Kerkesa te arketueshme dhe te tjera te arketueshme	-	-	1,008,296	1,008,296
Totali	266,768	672,940	114,434,046	115,373,773
Detyrime per t'u paguar	468,581	21,400,011	23,291,179	45,159,770
Huamarje	4,090,722	-	-	4,090,722
Totali	4,559,303	21,400,011	23,291,179	49,250,492
Pozicioni Neto Valutor	(4,292,515)	(20,727,071)	91,142,867	66,123,281

31 dhjetor 2019	Euro	USD	Leke	Totali
Mjete Monetare	75,758	54,300	70,377,915	70,507,973
Kerkesa te arketueshme dhe te tjera te arketueshme	-	-	1,045,045	1,045,045
Totali	75,758	54,300	71,422,960	71,553,018
Detyrime per t'u paguar	973,641	16,871,549	116,576,804	134,421,994
Huamarje	13,923,192	-	-	13,923,192
Totali	14,896,833	16,871,549	116,576,804	148,345,186
Pozicioni Neto Valutor	(14,821,075)	(16,817,249)	(45,153,844)	(76,792,168)

GFI Albania sh.p.k.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020

(shumat ne Lek)

(ii) Risku i kreditit

Rreziku i kreditit është rreziku i humbjes financiare për shoqërinë nëse klientët ose palet e tjera nuk përmbushin detyrimet kontraktuale dhe lind kryesisht nga llogaritë e arkëtueshme të shoqërisë. Ekspozimi i shoqërisë ndaj rrezikut të kreditit është kryesisht i influencuar nga karakteristikat individuale të çdo klienti. Shoqëria krijon një fond provigjoni për zhvleresim i cili përfaqëson vleresimet e shoqërisë për humbjet e ndodhura në lidhje me llogaritë e arkëtueshme bazuar tërësisht në humbjet specifike të lidhura me ekspozimë individualisht të rëndësishme.

Rreziku maksimal i ekspozimit të shoqërisë ndaj rrezikut të kreditit përfaqësohet nga vlera e mbetur e secilit aktiv të pasqyrës së pozicionit financiar të paraqitur më poshtë:

	2020	2019
Mjete monetare	114,365,477	70,507,973
Kerkesa të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme	1,008,297	1,045,045
Totali	115,373,774	71,553,018

GFI Albania sh.p.k.**Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020***(shumat ne Lek)***(iii) Risku i normës se interesit**

Të ardhurat e shoqërisë dhe fluksi monetar operues janë thellësisht të pavarura nga ndryshimet në treg të normës se interesit. Kompania nuk ka asetë që ndikohen në mënyrë domëthenëse nga përqindja e interesit.

31 Dhjetor 2020	Më pak se 6 muaj	Midis 6 dhe 12 muaj	Më shumë se 1 vit	Nuk mbartin interes	Totali
Aktive financiare					
Mjete monetare	114,365,477	-	-	-	114,365,477
Kerkesa të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme	1,008,297	-	-	-	1,008,297
Totali	115,373,774	-	-	-	115,373,774
Detyrimet financiare					
Detyrime për t'u paguar	25,292,925	9,973,977	118,740	-	35,385,642
Huamarrje	2,476,598	2,551,663	4,090,722	-	9,118,983
Totali	27,769,523	12,525,640	4,209,462	-	44,504,625
Hendeku i normës se interesit					
31 dhjetor 2020	87,604,251	(12,525,640)	(4,209,462)	-	70,869,149

31 Dhjetor 2019	Më pak se 6 muaj	Midis 6 dhe 12 muaj	Më shumë se 1 vit	Nuk mbartin interes	Totali
Aktive financiare					
Mjete monetare	70,507,973	-	-	-	70,507,973
Kerkesa të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme	1,045,045	-	-	-	1,045,045
Totali	71,553,018	-	-	-	71,553,018
Detyrimet financiare					
Detyrime për t'u paguar	21,161,749	10,733,383	102,526,862	-	134,421,994
Huamarrje	2,295,994	2,366,011	9,261,187	-	13,923,192
Totali	23,457,743	13,099,394	111,788,049	-	148,345,186
Hendeku i normës së interesit					
31 dhjetor 2019	48,095,275	(13,099,394)	(111,788,049)	-	(76,792,168)

GFI Albania sh.p.k.**Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020***(shumat ne Lek)**(c) Risku i Likuiditetit*

Rreziku i likuiditetit përcaktohet si rreziku që një njesi ekonomike do të përballet me vështirësi për të përmbushur detyrimet që lidhen me pasivet financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj nevojave të përditshme për burime monetare, kryesisht për të shlyer detyrimet e krijuara gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj normal. Drejtimi monitoron çdo ditë, javë dhe muaj duke bërë parashikime për flukset e parave.

Tabela më poshtë analizon detyrimet financiare sipas maturimit duke u bazuar në periudhën e mbetur nga data e raportimit deri në datën e maturimit sipas kontratës. Shumat e paraqitura në tabelën më poshtë janë flukset e parave të pa skontuara sipas kontratës. Balancat deri në 12 muaj barazohen me vlerën e tyre kontabel sepse ndryshimi më vlerën e skontuar nuk është i konsiderueshëm.

31 Dhjetor 2020	Më pak se 6 muaj	Midis 6 dhe 12 muaj	Më shumë se 1 vit	Totali
Aktive financiare				
Mjete monetare	114,365,477	-	-	114,365,477
Kerkesa të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme	1,008,297	-	-	1,008,297
Totali	115,373,774	-	-	115,373,774
Detyrimet financiare				
Detyrime për t'u paguar	25,292,925	9,973,977	118,740	35,385,642
Huamarje	2,476,598	2,551,663	4,090,722	9,118,983
Totali	27,769,523	12,525,640	4,209,462	44,504,625
Hendeku i likuiditetit të riskut më 31 dhjetor 2020	87,604,251	(12,525,640)	(4,209,462)	70,869,149

31 Dhjetor 2019	Më pak se 6 muaj	Midis 6 dhe 12 muaj	Më shumë se 1 vit	Totali
Aktive financiare				
Mjete monetare	70,507,973	-	-	70,507,973
Kerkesa të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme	1,045,045	-	-	1,045,045
Totali	71,553,018	-	-	71,553,018
Detyrimet financiare				
Detyrime për t'u paguar	21,161,749	10,733,383	102,526,862	134,421,994
Huamarje	2,295,994	2,366,011	9,261,187	13,923,192
Totali	23,457,743	13,099,394	111,788,049	148,345,186
Hendeku i likuiditetit të riskut më 31 dhjetor 2019	48,095,275	(13,099,394)	(111,788,049)	(76,792,168)

GFI Albania sh.p.k.
Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e
mbyllur me 31 dhjetor 2020

(shumat ne Lek)

5- Mjete monetare

Mjetet monetare më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Arka		
Lekë	41,577	87,138
Euro	-	-
	41,577	87,138
Llogari rrjedhëse		
Leke	113,384,172	70,290,777
Euro	266,788	75,758
Dollare Amerikanë	672,940	54,300
	114,323,900	70,420,835
Totali	114,365,477	70,507,973

6- Kërkesa te arketueshme dhe te tjera te arketueshme

Kërkesat e arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Llogari të arkëtueshme nga klientë	1,008,297	1,045,045
Garanci qiradhenësve	737,674	737,675
Të tjera të arkëtueshme	4,600	-
Totali	1,750,571	1,782,720

Garancia ndaj qiradhenësve konsiston në vlerën e garancisë të parashikuar në kontratën e qirase operacionale të ambientëve ku vepron Shoqëria, e cila është e kthyeshme në fund të afatit të qirase.

7- Inventari

Inventari i Shoqërisë më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhet si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Komponentë të markerit	8,681,777	71,577,421
Marker i gatshëm për përdorim	10,560,032	11,485,679
Materiale ndihmëse	3,214,224	2,338,007
Totali	82,456,033	85,401,107

Komponentët e markerit konsistojnë në koncentratin markues dhe në përberesit e tjere të cilët, si rrjedhojë e nënshtrimit të një procesi teknologjik përzierjeje, japin markerin e gatshëm për përdorim.

GFI Albania sh.p.k.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020

(shumat ne Lek)

8- Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 përbehen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Parapagime qiradhënësve	1,433,092	1,433,101
Tatimi mbi fitimin i parapaguar	-	2,068,408
Parapagim detyrimesh raport kontolli	11,620,950	11,620,950
Shpenzime për t'u shpërndare në disa periudha	1,457,594	1,486,933
Parapagime furnitoreve	901,452	3,689,922
Parapagime të tjera	-	24,610
Totali	15,413,089	20,323,924

Parapagimet e dhëna qiradhenësve konsistojnë në garanci të dhëna për kontratat e qirasë operationale të ambienteve ku vepron Shoqëria, të cilat janë të kthyeshmë në keste qiraje të parapaguara në muajt e fundit të qirasë.

Parapagim detyrimesh për raport kontolli konsiston në shumat e parapaguar në vitin 2018 për detyrimin qe rezulton nga "Raporti përfundimtar të Kontrollit Tatimor Nr. 12724/2, datë 02.05.2019 dhe Njoftimin e Vleresimit për Detyrimet Nr. 12724/3 Prot., datë 02.05.2018", për Tatim Fitimin në vlerën 12,526,354 Leke dhe për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në vlerën 10,715,546 Leke, të cilat shuma Shoqëria pretendon ti rekuperoje. Shoqëria në vitin 2019, ka njohur një shpenzim në masën 50 përqind të shumës së parapaguar, prej 11,620,950 Leke, për ceshtjen e cila vazhdon të jetë në proces gjyqësor gjatë vitit 2020.

Shpenzimet për t'u shpërndare në disa periudha për vitin 2020 konsistojnë në pjesën e paamortizuar të shpenzimeve administrative bankare që Shoqëria ka parapaguar për huamarrjen për garanci. dhe shpenzimet administrative të qirase financiare të cilat janë eshtë të amortizueshmë përgjatë gjithë periudhës së kontratës së koncensionit.(shënimi shpjegues 13).

Parapagimet e dhëna furnitorëve konsistojnë kryesisht në parapagime të dhëna Global Fluids International S.A. për blerjet e markerit dhe pajisjeve të tjera të përdorshme gjatë aktivitetit kryesor të Shoqërisë.

GFI Albania sh.p.k.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020

(shumat ne Lek)

9- Aktive afatgjata materiale

Aktivitet afatgjata materiale më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 përbehen si më poshtë:

Kosto historike	Toka	Ndertesa	Përmbledhim në qiramarje	Makinëri dhe pajisje	Mjete transporti	Orendi dhe pajisje zyre	Komputera dhe pajisje informatike	Total
Më 31 dhjetor 2018	27,558,990	77,971,890	19,073,079	66,323,785	37,749,216	6,542,969	10,072,896	245,292,825
Shtesa	-	-	-	6,780,951	-	45,777	210,641	7,037,369
Pakësime	-	(77,971,890)	-	-	-	-	-	(77,971,890)
Më 31 dhjetor 2019	27,558,990	-	19,073,079	73,104,736	37,749,216	6,588,746	10,283,537	174,358,304
Shtesa	-	-	-	11,434,830	-	37,500	-	11,472,330
Pakësime	-	-	-	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2020	27,558,990	-	19,073,079	84,539,566	37,749,216	6,626,246	10,283,537	185,830,639
Amortizim akumuluar								
Më 31 dhjetor 2018	-	(44,239,525)	(5,950,527)	(25,985,045)	(11,073,043)	(3,507,245)	(5,048,351)	(95,803,737)
Shtesa	-	(3,305,378)	(3,551,044)	(10,415,622)	(6,322,176)	(729,421)	(1,415,189)	(25,738,830)
Pakësime	-	47,544,903	-	-	-	-	-	47,544,903
Më 31 dhjetor 2019	-	-	(9,501,571)	(36,400,667)	(17,395,219)	(4,236,666)	(6,463,540)	(73,997,664)
Shtesa	-	-	(3,551,044)	(12,594,075)	(6,322,176)	(731,344)	(1,265,307)	(24,463,946)
Pakësime	-	-	-	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2020	-	-	(13,052,616)	(48,994,742)	(23,717,395)	(4,968,010)	(7,728,847)	(98,461,610)
Vlera e mbetur								
Më 31 dhjetor 2019	27,558,990	-	28,574,650	109,505,403	55,144,435	10,825,412	16,747,077	100,360,640
Më 31 dhjetor 2020	27,558,990	-	6,020,463	35,544,824	14,031,821	1,658,236	2,554,690	87,369,029

GFI Albania sh.p.k.**Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020***(shumat ne Lek)***10- Aktive afatgjata materiale**

Aktivet afatgjata jomateriale më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen si më poshtë:

	Programe kompjuterike	Shpenzimet e nisjes	Totali
Kosto historike			
Më 31 dhjetor 2018	10,560,803	31,227,670	41,788,473
Shtesa	-	-	-
Pakësime	-	-	-
Më 31 dhjetor 2019	10,560,803	31,227,670	41,788,473
Shtesa	-	-	-
Pakësime	-	-	-
Më 31 dhjetor 2020	10,560,803	31,227,670	41,788,473
Amortizim i akumuluar			
Më 31 dhjetor 2018	(3,165,259)	(17,175,219)	(20,340,477)
Shtesa	(1,751,703)	(3,122,767)	(4,874,470)
Pakësime	-	-	-
Më 31 dhjetor 2019	(4,916,962)	(20,297,986)	(25,214,947)
Shtesa	(1,751,703)	(3,122,767)	(4,874,470)
Më 31 dhjetor 2020	(6,668,665)	(23,420,753)	(30,089,417)
Vlera e mbetur			
Më 31 dhjetor 2019	5,643,841	10,929,685	16,573,526
Më 31 dhjetor 2020	3,892,139	7,806,918	11,699,056

11- Detyrimet per t'u paguar dhe parapagime

Detyrimet për t'u paguar dhe parapagimet më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Të pagueshme ndaj Ministrise se Financave	9,973,977	10,733,383
Tatim mbi vleren e shtuar (DPT)	5,962,158	6,791,205
Sigurime shoq. dhe shend. dhe tatim mbi të ardhurat personale	3,385,820	3,526,291
Tatim në burim	98,768	101,278
Tatimi mbi fitimin për tu paguar	9,774,085	-
Të pagueshme ndaj furnitoreve	22,431,866	18,219,851
Furnitore për fatura të pamberritura	569,458	625,415
Të pagueshme ndaj punonjesve	2,861,059	2,41,898
Të pagueshme ndaj të tretëve	44	-
Të pagueshme ndaj ortakëve	118,740	102,526,862
Totali	55,175,975	145,466,183

Vlera e pagueshme ndaj Ministrisë së Financave përbën tarifën koncesionare të përlogaritur si 2.5% të të ardhurave nga aktiviteti i Shoqërisë, siç përcaktohet në Kontratën e Koncesionit.

GFI Albania sh.p.k.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020

(shumat ne Lek)

12- Të ardhura të marra në avancë

Më 31 dhjetor 2020 Shoqëria ka të ardhura të marra në avancë nga klientët e saj si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Të ardhura të marra në avancë	6,711,407	5,368,519
Totali	6,711,407	5,368,519

13- Huamarrje

Huamarrjet përbehen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Pjesa afatshkurtër:		
Interesa	-	-
Hua bankare	-	-
Leasing	5,028,261	4,662,005
	<u>5,028,261</u>	<u>4,662,005</u>
Pjesa afatgjatë:		
Hua bankare	-	-
Hua nga Gold Coast Nominies .	-	-
Leasing	4,090,722	9,261,187
	<u>4,090,722</u>	<u>9,261,187</u>
Totali	9,118,983	13,923,192

Shoqëria ka në fund të vitit vetëm detyrime për qira financiare me shoqërinë Albanian Financial Institution sh.p.k.pranë së cilës shoqëria GFI Albania sh.p.k. ka marrë më qira financiare 13 automjete.

14- Provizione afatshkurta

Provizionet afatshkurtra më datë 31 dhjetor 2020 janë si më poshtë vijon:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Provizion për çështje gjyqësore	10,447,274	10,447,274
Totali	10,447,274	10,447,274

Shoqëria ka krijuar provizion gjatë vitit 2018 në lidhje me gjobat dhe interesat e papaguara, sipas Raport Kontrollit.

Shoqëria GFI Albania sh.p.k. vazhdon të jetë në proces gjyqësor gjatë vitit 2020, me Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj.

GFI Albania sh.p.k.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020

(shumat ne Lek)

15- Te ardhura nga aktivitetet e markimit

Të ardhurat nga aktiviteti i markimit konsistojnë vetëm në të ardhurën nga shërbimi i markimit të hidrokarbureve të llogaritur në bazë të çmimit fiks për litra hidrokarburesh të markuara, siç parashikohet në Kontratën e Koncesionit.

16- Të ardhura të tjera

Të ardhura të tjera janë si më poshtë vijon:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura nga qiraja	-	1,120,520
Të ardhura nga shitja e aktiveve afatgjata	-	8,048,513
Të ardhura nga dhuratat	-	-
Të ardhura nga zhvendimet nga sigurimi	-	-
Të ardhura nga rregullime për tatim fitimin	-	296,106
Totali	-	9,465,139

17- Kosto e markerit

Kosto e markerit përbehet nga kostoja e lëndës markuese të përdorur gjatë markimit të hidrokarbureve siç parashikohet në Kontratën e Koncesionit.

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Kosto e markerit	(74,439,855)	(81,375,234)
Totali	(74,439,855)	(81,375,234)

18- Kosto e punës

Kosto e punës përbehet si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Pagat e personelit	86,262,481	102,135,590
Shpenzimet për sigurime shoqerore dhe shëndetësore	11,302,934	11,592,444
Totali	97,565,415	113,728,034

19- Tarife konçensioni

Tarifa e koncesionit për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2020 konsiston në shpenzimin e njohur nga Shoqëria për tarifen e koncesionit sipas Kontratës Koncesionare.

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Tarife konçensioni	9,973,981	10,733,387
Total	9,973,981	10,733,387

GFI Albania sh.p.k.**Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020***(shumat ne Lek)***20- Shpenzime administrative**

Shpenzimet administrative për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 përbehen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Shpenzime për shërbime komunale	508,714	721,889
Taksa lokale, shpenzime doganore dhe të ngjashmë	620,282	348,833
Shpenzime qiraje ambientësh	8,248,923	9,192,948
Shpenzime qiraje automjetësh	-	-
Shpenzime për prime sigurimi	116,589	-
Sherbimë ruajtje	3,420,000	3,350,000
Shpenzime konsulence ligjore dhe të ngjashmë	13,299,087	7,352,662
Shpenzime konsulence financiare	5,427,357	6,182,094
Shpenzime laboratorike	756,218	1,309,389
Shpenzime transporti dhe karburanti	5,699,381	5,547,687
Shpenzime kancelarie	585,138	680,899
Shpenzime trajnimi	-	1,522,140
Shpenzime përfaqësimi	256,000	277,490
Shpenzime materiale konsumi	1,199,467	1,668,772
Shpenzime mirembajtje	2,467,645	2,921,867
Shpenzime komunikacioni dhe informacioni	1,482,508	1,614,891
Shpenzime për personelin (akomodim, dieta, uniforma etj.)	3,623,059	5,626,590
Shpenzime provigjoni për detyrime tatimore raport kontrolli	-	11,620,950
Shpenzime për gjoba	-	-
Shpenzime të ndryshme	2,548,661	3,395,514
Shpenzime konsulence tregtare dhe logjistike	170,000	1,459,487
Shpenzime zhvlerësimi nga përmbytja	-	-
Shpenzime për koeficient moskreditimi	2,900	893
Total	50,431,929	64,794,995

21- Të ardhura (shpenzime) të tjera financiare, neto

Të ardhurat (shpenzimet) të tjera financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura interesi:		
Depozitë bankare	-	145,385
	-	145,385
Shpenzime interesi dhe komisioni :		
Interesa overdraft (ISP)	(8,801)	(39,704)
Interesa hua bankare (ISP)	-	(1,675,041)
Interesa leasing	(771,837)	(1,081,975)
Interesa hua nga Gold Coast Nomines	-	(43,558)
Komisionë bankare dhe leasing	(827,802)	(951,632)
	(1,608,440)	(3,791,910)
Shpenzime financiare, neto	(1,608,440)	(3,646,525)

GFI Albania sh.p.k.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020

(shumat ne Lek)

22- Te ardhura (shpenzime) nga kurset e kembimit, neto

Të ardhurat (shpenzimet) nga kurset e këmbimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë si më poshtë :

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Fitimë të realizuara nga kursi i këmbimit	6,922,052	2,801,604
Fitimë të parealizuara nga kursi i këmbimit	-	370,696
	6,922,052	3,172,300
Humbje të realizuara nga kursi i këmbimit	-	(2,334,652)
Humbje të parealizuara nga kursi i këmbimit	(8,802,619)	(1,559,066)
	(8,802,619)	(3,893,718)
Fitimë nga kembimi, neto	(1,880,567)	(721,418)

23- Tatim-fitimi

Në përputhje më ligjet tatimore shqiptare, norma e aplikueshme për tatimin mbi fitimin për vitin 2020 është 15% (2019:15%).

Deklaratat tatimore dorezohen çdo vit por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qellime tatimi konsiderohen vetëdeklarime deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

Shoqëria për vitin 2020 rezulton më fitim neto si për qellime kontabel ashtu dhe për qellime fiskale.

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Tatim-fitimi	21,865,807	23,443,004
TOTALI	21,865,807	23,443,004

GFI Albania sh.p.k.**Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020***(shumat ne Lek)**Rakordimi i normës efektive të tatimit / i rezultatit kontabel më rezultatin fiskal*

	%	2020	%	2019
Fitimi (Humbje) e vitit		133,720,702		133,187,726
Tatim-fitimi më shkallën tatimore standard	15%	20,058,105	15%	19,978,159
Rregullimë për:				
<u>Të ardhura të tatueshmë</u>	0%		0%	(44,417)
<u>Shpenzime të pazbritshmë</u>				
Shpenzime administrative	0%	217,852	0%	392,347
Penalitete dhe humbje të tjera	0%	-	1%	46,789
Shpenzime amortizimi	1%	1,589,850	1%	1,326,983
Provizion Raport Kontrolli	0%	-	1%	1,743,143
Tatim-fitimi i vitit	16%	21,865,807	17%	23,443,004

Më 31 dhjetor 2020, Shoqëria nuk ka njohur detyrime apo aktive tatimore të shtyra.

24- Pale te lidhura

Në vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020, transaksionet më pale të lidhura i korrespondojnë shumave të parapaguara ndaj tyre në cilësinë e furnitorit të Shoqërisë më koncentrat markimi dhe pajisje të tjera.

	2020	2019
<i>Transaksione më Global Fluids International S.A.</i>	<i>21,052,384</i>	<i>17,859,608</i>
Kërkesa të arkëtueshme për blerje	20,881,640	16,871,549
Parapagime për furnizime	170,744	869,320
Të pagueshme ndaj ortakëve për dividend	-	44,183
Të pagueshme ndaj ortakëve kapital	-	74,556
 <i>Transaksione më Petroleum Consulting Partners A.G.</i>	 -	 <i>102,408,123</i>
Huamarrje	-	-
Interesa	-	-
Të pagueshme ndaj ortakëve për dividend	-	63,074,748
Të pagueshme ndaj ortakëve kapital	-	39,333,375

GFI Albania sh.p.k.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020

(shumat ne Lek)

25- Angazhime dhe pasiguri

Çështje ligjore

Gjatë aktivitetit të zakonshëm, shoqëria mund të përfshihet në dëme dhe çështje ligjore. Në gjykimin e drejtimit, shoqëria nuk do të ketë ngjarje më peshe të konsiderueshme për të ndikuar në pozicionin financiar të saj ose për të ndryshuar vlerën neto të aktiveve, përveç atyre për të cilat është njohur një provizion në pasqyrat financiare.

Në lidhje me "Raportin Përfundimtar të Kontrollit Tatimor Nr. 12724/2, datë 02.05.2018 dhe Njoftimin e Vleresimit për Detyrimet Nr. 12724/3 Prot., datë 02.05.2018", Shoqëria ka apeluar çështjen dhe vazhdon të jetë në proces gjyqësor me Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj.

Detyrime të kushtëzuara

Shoqëria nuk ka detyrime të kushtëzuara të rëndësishme të kontraktuara deri në datën e pasqyrës së pozicionit financiar të cilat nuk janë njohur në pasqyrat financiare.

26- Ngjarje te mepasshme

Drejtimi i Shoqërisë nuk është në dijeni të ndonjë ngjarje të mëpasshem pas datës së raportimit të pasqyrave financiare të cilat mund të kërkojnë rregullim apo shpjegim në keto pasqyra financiare.